

ABSTRAKTI

Me efektet e tij pozitive që përcjellë në zhvillimin ekonomik e social, promovimin e kulturës, njohjen e vlerave natyrore dhe jo vetëm, turizmi përbën një ndër veprimtaritë më të çmuara e të vlefshme të një vendi. Megjithatë, krahas të mirave që sjellë, zhvillimi i tij dhe rritja e aktiviteteve turistike, zbulojnë ndonjëherë edhe anën e tyre të "errët", duke lënë gjurmë të dukshme mbi peisazhet natyrore dhe mjediset më delikate, veçanërisht, në zonat e mbrojtura. Varësisht nga mënyra se si dhe ku manifestohet, ai mund të shkaktojë presion duke sjellur transformime të dukshme hapësinore. Parku Kombëtar "Sharri", përfaqëson një shembull të qartë të këtij fenomeni, ku zhvillimi turistik në zonat e Brezovicës dhe Prevallës, dy destinacione të njohura për turizëm në Kosovë, ka shkakuar ndryshime të dukshme në shfrytëzimin e tokës. Studimi fokusohet të analizojë ndikimin e aktivitetit turistik në ndryshimin e shfrytëzimit të tokës, zhvillimin urban dhe ekologjinë e këtyre zonave. Për të vlerësuar ndryshimet hapësinore gjatë periudhave të ndryshme kohore dhe për të kuptuar ndikimin e infrastrukturës turistike mbi këto zona, metodologjia e përdorur për këtë studim, kombinon shqyrtimin e literaturës ekzistuese, të dhënat dhe raportet zyrtare nga institucionet relevante, me analizën gjeo-hapësinore përmes veglave që ofrojnë softuerët e Sistemit të Informacionit Gjeografik (GIS). Rezultatet në një masë identifikojnë dhe shpjegojnë problemet e zhvillimit të organizimit hapësinor dhe funksional të zonave të mbrojtura në Parkun Kombëtar "Sharri". Gjetjet treguan një tendencë të rritjes së zonës së ndërtimit, me një zgjerim të infrastrukturës turistike dhe një rritje të kërkesës për shërbime dhe akomodim, duke çuar në shndërrimin e hapësirave natyrore në zona të ndërtimit. Përveç kësaj, ka një zvogëlim të konsiderueshëm të sipërfaqeve pyjore, i cili lidhet drejtpërdrejtë me presionin e aktivitetit turistik dhe ndërtimit. Ky fenomen ka pasoja të rëndësishme për biodiversitetin dhe ekosistemet lokale. Ky hulumtim ofron gjithashtu rekomandime për menaxhimin e qëndrueshëm të turizmit dhe ruajtjen e pasurisë natyrore, duke sugjeruar zhvillimin e strategjive që balancojnë nevojat e turizmit me mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Fjalë kyqe: turizëm, zona të mbrojtura, Parku Kombëtar "Sharri", Brezovicë, Prevallë, Shfrytëzimi i tokës

Hyrje

Parku Kombëtar "Sharri", ashtu si edhe vetë territori i Republikës së Kosovës, shtrihet në pjesën qendrore të Gadishullit Ballkanik, një pozicion strategjik që e vendos atë në kryqëzimin e rëndësishëm të rrugëve lindje-perëndim (midis Detit të Zi dhe Detit Adriatik) dhe veri-jug (midis Evropës Qendrore dhe Detit Egje). Ky pozicion gjeografik i favorshëm i jep rajonit një rëndësi të veçantë, jo vetëm nga aspekti ekologjik dhe gjeopolitik, por edhe në kuadër të zhvillimit të turizmit dhe ekonomisë lokale.

Maleve të Sharrit, që përbëjnë një ndër masivet më të mëdha malore në Ballkan, e brenda territorit të Kosovës përfshihet një sipërfaqe prej rreth 1100 km², apo afërsisht 10% të territorit të përgjithshëm të vendit. Ndërkohë, pjesa jugore e këtij masivi malor, me një sipërfaqe prej 500 km², shtrihet brenda territorit të Maqedonisë së Veriut. Kufiri shtetëror ndërmjet dy vendeve përkon me vijën e kreshtave malore që përshkrijnë majat më të larta të Sharrit, duke krijuar një kufi natyror mes Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut.

Nga ana hidrografike dhe gjeomorfologjike, ky rajon lidhet përmes luginës së lumit Lepenc (Siriniq) me Fushën e Kosovës, ndërsa përmes luginës së Lumëbardhit të Prizrenit (Sredska), lidhet me Rrafshin e Dukagjinit, duke krijuar një sistem të rëndësishëm natyror dhe rrugor që mundëson lëvizje të lehtë të njerëzve dhe zhvillim të potencialeve turistike në të dyja drejtimet (Plani Hapësinor PK-Sharri, 2013).

Sipas këtij Plani Hapësinor, në zonën e tretë të mbrojtjes të Parkut Kombëtar "Sharri" janë identifikuar nëntë zona të dedikuara për zhvillimin e turizmit, me një sipërfaqe të përgjithshme prej 3769.81 hektarësh, që përbëjnë rreth 7.1% të territorit të parkut. Disa nga këto zona më të njohura përfshijnë Brezovicën (3426 ha, në komunën e Shtërpcës) dhe Prevallën (31 ha, në komunën e Prizrenit), të cilat ofrojnë kushte të favorshme për zhvillimin e turizmit dimëror dhe veror (Plani Hapësinor PK-Sharri, Prishtinë, 2013).

Për të mundësuar zhvillimin e turizmit në këto zona të mbrojtura, autoritetet publike kanë vendosur që përmes mekanizmit të koncesioneve t'u japin subjekteve private të drejtën e përdorimit të tokës, duke respektuar kornizën ligjore të Republikës së Kosovës dhe kriteret e mbrojtjes së mjedisit. Kjo qasje synon të krijojë një balancë të qëndrueshëm ndërmjet zhvillimit ekonomik dhe ruajtjes së pasurisë natyrore të parkut.

Ligji për Parkun Kombëtar "Sharri", i miratuar në vitin 2013, ka për qëllim mbrojtjen dhe promovimin e kësaj hapësire të veçantë natyrore. Parku është shpallur zonë e mbrojtur për shkak të vlerave të tij të jashtëzakonshme natyrore, ekologjike dhe kulturore. Ai përfshin pyje të ruajtura, një numër të madh ekosistemesh pyjore dhe të tjera, shumë prej të cilave janë habitate për specie endemike dhe relikte. Parku gjithashtu paraqet rëndësi të veçantë për shkak të karakteristikave të tij gjeomorfologjike, hidrologjike, si dhe vlerave shkencore, kulturore, historike, peizazhore dhe rekreative, (RAPORTI PER GJENDJEN E NATYRES 2018 – 2021) Të gjitha këto elemente kontribuojnë në krijimin e një hapësire të përshtatshme për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm dhe aktiviteteve që kanë ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik të rajonit.

Turizmi në këtë park është i mbështetur kryesisht në vizitorë individualë që kërkojnë përvoja me ndikim pozitiv: psikologjik, social dhe fizik. Kërkimi për përfitime nga përjetimet natyrore është një nga motivet bazë të zhvillimit të turizmit në zona të mbrojtura. Për këtë arsye, Parku Kombëtar "Sharri" përbën një aset të çmuar jo vetëm për ruajtjen e biodiversitetit, por edhe për krijimin e mundësive të reja për zhvillimin ekonomik lokal dhe përmirësimin e mirëqenies së komuniteteve që jetojnë në afërsi të tij.

Figura 1. Cikli (rrethi) i virtutshëm, bazuar nga autori (Paul F.J.Eagles, 2024)

Figura më lartë paraqet një cikël (rreth) që përshkruan marrëdhënien ndërmjet qëndrimeve, vlerësimit dhe përfitimit nga një zonë e pasur me burime natyrore dhe kulturore.

Ky Punimi ynë i emëruar si në titullar trajton tendencat e ndryshimit të destinimit të tokës dhe ndikimin e tyre në planifikimin dhe menaxhimin e parqeve dhe zonave të mbrojtura në zonat e njohura si turistike: Brezovicës dhe Prevalles në një perspektivë afatmesme. Sipas autorëve Gartner dhe Lime (2000), ekziston një marrëdhënie e ndërlidhur dhe shpesh ambivalente midis zonave të mbrojtura dhe zhvillimit të turizmit. Ata argumentojnë se, megjithëse ka një sërë tendencash të identifikueshme, disa prej tyre kanë potencialin të ndikojnë ndjeshëm në mënyrën e menaxhimit të turizmit brenda këtyre zonave.

Në këtë kontekst, roli i parqeve dhe turizmit pritet të pësojë transformime si përgjigje ndaj ndryshimeve në nevojat shoqërore, përparimeve teknologjike dhe sfidave gjithnjë e më të mëdha mjedisore. Këto ndryshime nuk përfaqësojnë vetëm sfida për menaxhimin efektiv të zonave të mbrojtura, por gjithashtu hapin mundësi të shumta për krijimin e përfitimeve të qëndrueshme, si për komunitetet lokale ashtu edhe për ruajtjen e trashëgimisë natyrore dhe kulturore. Në këtë kuadër, është thelbësore të zhvillohen politika dhe praktika menaxheriale të orientuara drejt një bilanci të qëndrueshëm ndërmjet mbrojtjes së natyrës dhe zhvillimit të turizmit.

Modelet e turizmit

Tema që kemi zgjedhur trajton ndikimin e zhvillimit turistik në ndryshimet e përdorimit të tokës, duke analizuar mënyrën se si zgjerimi i aktiviteteve turistike po ndikon në transformimin e peizazhit natyror dhe strukturës ekonomike të zonave malore të Brezovicës dhe Prevalles. Përmes kësaj teme synohet të kuptohet se si turizmi, si një sektor gjithnjë në rritje, mund të shërbejë si motor zhvillimi, por njëkohësisht të paraqesë sfida serioze për mjedisin dhe planifikimin hapësinor.

Turizmi është shndërruar në një sektor kyç të aktivitetit ekonomik që nga fundi i shekullit XX, dhe të gjitha të dhënat tregojnë se kjo prirje do të vazhdojë edhe në vitet në vijim. Rritja e vazhdueshme e këtij sektori është shoqëruar me një diversifikim të konsiderueshëm të produkteve dhe destinacioneve turistike, ku vihet re një interes i shtuar për format e turizmit të lidhura me natyrën, si ekoturizmi, vizitat në parqe kombëtare dhe natyrore, si dhe turizmi rural (Eagles, McCool, & Haynes, 2002).

Njëkohësisht, edhe profili i turistëve ka evoluuar. Ata po bëhen gjithnjë e më kërkuar dhe të sofistikuar, jo vetëm në aspektin e infrastrukturës dhe luksit të akomodimit, por edhe në kërkesën për përvoja kuptimplota. Kjo përfshin elemente të tilla si autenticiteti kulturor, ndërveprimi me komunitetet lokale, si dhe mësimi dhe ndërgjegjësimi për biodiversitetin, florën dhe faunën, eksistimet dhe ruajtjen e natyrës në tërësi (Eagles et al., 2002).

Turizmi mund të ndahet në dy forma kryesore: turizmin masiv dhe turizmin alternativ (Smith & Eadington, 1992).

Turizmi masiv përfshin udhëtime të një numri të madh vizitorësh drejt destinacioneve të njohura dhe të zhvilluara, shpeshherë të fokusuara në relaksim, argëtim dhe komoditet.

Në të kundërt, turizmi alternativ – i njohur gjithashtu si "turizëm me interes të veçantë" ose "turizëm i përgjegjshëm" – përfaqëson forma të turizmit që theksojnë ndërveprimin e turistëve me banorët vendas, mënyrën e tyre të jetesës dhe mjedisin natyror. Kjo qasje synon të krijojë përvoja më autentike dhe edukative, duke respektuar parimet e zhvillimit të qëndrueshëm. Format e këtij

turizmi përfshijnë turizmin kulturor dhe të trashëgimisë, ekoturizmin, agroturizmin dhe nisma të bazuara në partneritet, siç janë zonat e mbrojtura dhe të trashëgimisë natyrore e kulturore (Smith & Eadington, 1992). Modele për zhvillimin e turizmit të festivaleve si alternativa shpresëdhënëse, të kontekstualizuara në rastine Kosovës dhe që i shërbejnë të njëjtit rajon me studimin tonë, paraqiten në studimet e fundme të autorëve Humolli & Ukshini (2025).

Rasti i Lungaut, Austri – Një shembull i mirë i zhvillimit të turizmit të qëndrueshëm
Lungau është një nën-rajon malor në pjesën juglindore të Landit të Salzburgut në Austri, me një popullsi prej rreth 21,000 banorësh të shpërndarë në 15 komuna. Rajoni përbëhet nga një kompleks i pasur luginash të ndërlidhura dhe është karakterizuar nga një peizazh i ruajtur dhe tërheqës.

Turizmi në Lungau përbën një komponent të rëndësishëm të ekonomisë vendore, por nuk është dominuese. Rreth 600 persona janë të punësuar direkt në këtë sektor, që përfaqëson rreth 10% të vendeve të punës në rajon, ndërsa përlogaritjet që rreth 20% e të gjitha vendeve të punës janë të varura nga turizmi në mënyrë të tërthortë (A. Sokoli, 2021).

Zona ofron rreth 250 km shtigje skijimi ndërkomunale dhe pesë qendra të skive, pa prani të zhvillimit të rëndë industrial të sporteve dimërore. Gjatë verës, vizitorët tërhiqen nga mundësia për të shijuar natyrën, për të eksploruar malet dhe për të bërë ecje.

Shembulli i Lungaut dëshmon se është e mundur të zhvillohet një turizëm i qëndrueshëm, i cili mbështet ekonominë lokale, por që njëkohësisht mbron resurset natyrore dhe kulturore të rajonit.

Ky model mund të shërbejë si frymëzim për zonat e mbrojtura në Kosovë, si Brezovica dhe Prevala, ku potenciali për zhvillim të qëndrueshëm turistik është i lartë.

Foto 1. Pistës së skijimit në Lungau, Salzburg, Austri (Burimi: Foto nga interneti)